Kronikë

Operacioni 'Revanshi' / Arrestohet 21 vjeçari, strehoi Marklen Hakën! Në banesën ku fshihej i kërkuari i SPAK u gjet dhe një pistoletë (EMRI)

Një 21 vjeçar u vu në pranga nga policia, pasi ndihmoi të fshihej në banesën e tij i shumëkërkuari i drejtësisë, Marklen Haka. Në banesë, të riut iu fgjet dhe një armë zjarri pistoletë.

■ VIDEO/ U përballën në Drejtorinë e Tiranës, çfarë i tha Marklen Haka nën pranga e i zbathur Tonin Vocajt

■ VIDEO/ Kur RENEA bastisi banesën ku fshihej Haklaj

■ Operacioni 'Revanshi'/ RENEA arreston Marklen Hakën, pjesë e 'Bandës së Niklës', do vriste Durim Bamin! 4 ditë nën vëzhgim, tentoi të ikte kur u bastis banesa (VIDEO)

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
7 Shtator, 10:18 | **Përditesimi: 7 Shtator, 16:29**

Share

Policia ditën e djeshme arrestoi në Nikël të shumëkërkuarin e drejtësisë Marklen Haka. Krahasi tij u shoqëruan për në DVP Tiranë edhe 4 persona të tjerë. Mes të 4 arrestuarve të tjerë është edhe Klajdi Haka, i afërm i Marklen Hakës, i cili ndihmoi të shumëkërkuarin e drejtësisë të fshihej në banesën e tij në Nikël, në Liqenin e Bacungut., 21 vjeç.

Në banesën e të riut Klajdi Haka, u gjet dhe sekuestrua një armë zjarri pistoletë. 21 vjeçari u vu në pranga për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit".

> *'Në vijim të operacionit policor të koduar "Liqeni i Bacungut", të dhënë ditën e djeshme, u arrestua shtetasi K. H., 21 vjeç, banues në Zezë, Nikël, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit", parashikuar nga nenet 278/4 dhe 302 të Kodit Penal.*

LEXO EDHE:
VIDEO/ U përballën në Drejtorinë e Tiranës, çfarë i tha Marklen Haka nën pranga e i zbathur Tonin Vocajt

> *Gjatë kontrollit të banesës së shtetasit K. H., (banesa ku fshihej shtetasi M. H., alias M. A.) është gjetur dhe sekuestruar, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë.', njofton policia.*

Ka qenë ora 14:00 e ditës së djeshme kur RENEA hyri në banesën ku fshihej Marklen Haka në afërsi të Liqenit të Bacungut, Nikël, Krujë. Për 4 ditë (nga data 2 shtator) Haka është mbajtur nën vëzhgim deri në momentin kur dhe është vendosur për të ndërhyrë duke bastisur banesën dhe duke e kapur 33 vjeçarin papritur, zbathur, me bluzë të bardhë e pantallona të shkurtra. Në momentet kur RENEA ka ndërhyrë, Haka ka tentuar të arratiset por është ndaluar nga forcat e policisë, ndërsa në banesë iu gjet edhe një armë zjarri.

Marklen Haka ishte shpallur në kërkim ndërkombëtarë pas vendimit të Gjykatës së Posaçme më 15 maj të këtij viti për 'arrest me burg' në mungesë' për vrasje me paramendim e mbetur në tentativë ndaj Durim Bamit.

G.K/S.DH/Shqiptarja.com

TAG: marklen haka | Klajdi Haka | nikel | fushe kruje

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ikën Rrumbullaku dhe 12 drejtorët e policive në qarqe, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Protestë në Thumanë-Kashar/ Një pjesë kërkon mosbllokim të aksit, por hasin kundështimin e eksponentëve të PD-së
Julian Shota
6 Shtator, 18:40

Arrestimi i Marklen Hakës/ Gazetari Sokol Dema: U kap tek banesa e një të afërmi! Softa: Shpresoj të kthehet në bashkëpunëtor
6 Shtator, 17:48

SKEDA/ Konfliktet hakmarrëse mes Marklen Hakës dhe Gentjan Bejtjas! Vrasja e hallës, atentatet në seri mes tyre dhe vrasjet
6 Shtator, 16:08

Operacioni 'Revanshi'/ RENEA arreston Marklen Hakën, pjesë e 'Bandës së Niklës', do vriste Durim Bamin! 4 ditë nën vëzhgim, tentoi të ikte kur u bastis banesa (VIDEO)
6 Shtator, 15:49

Bllokohet Thumanë-Kashar/ Banorët protestojnë për herë të dhjetë, kërkojnë hyrje dhe dalje për zonat e tyre
3 Shtator, 18:46

Protestë në Thumanë-Kashar, banorët përplasen me policinë: Do çojmë në SPAK Belinda Ballukun e ARRSH
30 Gusht, 19:36

Protestë në Thumanë-Kashar, tensione mes policisë dhe banorëve, kërkohet hyrje dhe dalje për zonat e Krujës dhe Fushë-Krujës
26 Gusht, 19:25

Protesta e katërt në Thumanë-Kashar, banorët kërkojnë hyrje dhe dalje për zonat e tyre! Përplasje me policinë
8 Gusht, 18:49

Operacioni 'Revanshi'/ Autoritetet në Dubai thonë se kanë ndaluar Marklen Hakën! Policia shqiptare i dërgon të dhënat biometrike
31 Korrik, 21:06

Banorët e Krujës e Fushë-Krujës sërish në protestë! Bllokojnë aksin Thumanë-Kashar, përplasen me policinë (VIDEO)
29 Korrik, 18:43

Fushë-Krujë/ Kultivoi bimë narkotike, arrestohet 60 vjeçari
17 Korrik, 09:21

Shpërthim me tritol në banesën e 50-vjeçarit në Fushë-Krujë, policia në kërkim të autorit (EMRI+VIDEO)
18 Maj, 22:54

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje